

Alma Mile

**“HYLLI I DRITËS”
REVISTA E FRANÇESKANËVE TË DËNUAR
NGA REGJIMI KOMUNIST**

Abstrakt

Censura ishte një fenomen i zakonshëm gjatë shek. XX. E hasur gjatë regjimit të Mbretit Zog, por që kulmoi gjatë regjimit komunist. Në shenjestër ishin intelektualët dhe mendimi ndryshe. Revista “Hylli i Dritës” ishte një nga ato organe që u censurua si gjatë regjimit të Zogut aq edhe gjatë diktaturës komuniste. Revista “Hylli i Dritës” është një nga revistat më jetëgjata fetaro-kulturore, u themelua në Shkodër në vitin 1913 prej At Gjergj Fishtës në një kontekst të ndërlikuar politik e shoqëror. Në faqet e saj shkruan emrat më të mëdhenj jo vetëm të urdhrit françeskan, por edhe shkrimtarë, poetë e studiues të njohur të kohës, që nga At Gjergj Fishta, At Anton Harapi, Vinçenc Prennushi, Gjon Shllaku, Dom Lazër Shantoja, Eqrem Çabej, Norbert Jokl etj. Ashtu si e tregon vetë emri, “Hylli i Dritës” u kthye në një fanar orientues jo vetëm për besimtarët katolikë, por për të gjithë shqiptarët, që atdheun e kishin mbi të gjitha. Por pikërisht për këtë arsye, “Hylli i Dritës” ka qenë një shënjestër e politikës, qoftë gjatë periudhës së mbretërimit të Zogut I, kohë gjatë së cilës

njohu disa pezullime, qoftë gjatë regjimit komunist, kur pësoi edhe goditjen më të rëndë. Ajo pësoi të njëjtën fat si edhe drejtuesit e saj. Përmes makinacionesh, manipulimesh, urdhrash, gjyqesh të rreme, kleri katolik u përdoq, u akuzua dhe dënua si të ishte një organizatë kriminale. Dhjetra personalitete të klerit katolik dhe të letrave shqipe u dënuam me pushkatim apo vite të gjata burgimi, ku për shkak të torturave humbën jetën shumë syresh. Përmes këtij punimi ofrohet historiku, përndjekja dhe mbijetesa e një prej revistave kulturore më të rëndësishme të gjysmës së parë të shek. XX

Fjalëkyçe: Hylli i Dritës, revistë, At Gjergj Fishta, diktaturë, Mbreti Zog I

“Hylli i Dritës asht ma i pari që lajmëron agun, diellin që mbas pak do të shndrisin. Nji vit mbas shpalljes së Pamvarsisë së Shqipnisë Fretnit françeskan pagzuen të përkohshmen e tyne zâmadhe me ketë emën, mbasi shihnin dritë e bekueme që do të shndriste ma në fund edhe mbi Shqipninë e lirë”. Revista “Hylli i Dritës”, një nga revistat më jetëgjata fetaro-kulturore, u themelua në Shkodër në vitin 1913 prej At Gjergj Fishtës në një kontekst të ndërlikuar politik e shoqëror.

“Kur në Vlorë u shpall pamvarësia shumica e shqiptarëvet ishin gjithnji në terr. Kohët vazhdonin t’ishin të turbullta: injoranca kishte mblue dhenë. Atëherë lindi ‘Hylli i Dritës’. ‘Tash qi u ba Shqipnia, duhen përba

*shqypstarët’, shkruente Fishta. Sepse ni pjesë e shqiptarëve nuk kishin besim në Shqipni”, thotë At Zef Pllumi*²⁶.

Numri i parë i revistës mban datën 1 tetor 1913 dhe u shtyp në shtypshkronjën “Nikaj”. Në faqet e saj shkruan emrat më të mëdhenj jo vetëm të urdhrorit françeskan, por edhe shkrimtarë, poetë e studiues të njohur të kohës. Një revistë me pretendimin për të mos u bërë si “shtampat” e tjera që “*t’shumen e herave bahen kavia e rrmimit t’sajë*”²⁷.

Ashtu si e tregon vetë emri, “Hylli i Dritës” u kthye në një fanar orientues jo vetëm për besimtarët katolikë, por për të gjithë shqiptarët, që atdheun e kishin mbi të gjitha. Por pikërisht për këtë arsye, “Hylli i Dritës” ka qenë një shënjestër e politikës, qoftë gjatë periudhës së mbretërimit të Zogut I, kohë gjatë së cilës njohu disa pezullime, qoftë gjatë regjimit komunist, kur pësoi edhe goditjen më të rëndë. Ajo pësoi të njëjtën fat si edhe drejtuesit e saj. Përmes makinacionesh, manipulimesh, urdhrash, gjyqesh të rreme, kleri katolik u përndoq, u akuzua dhe dënua si të ishte një organizatë kriminale. Dhjetra personalitete të klerit katolik dhe të letrave shqipe u dënuam me pushkatim apo vite të gjata burgimi, ku për shkak të torturave humbën jetën shumë syresh.

²⁶ Pllumi, Atë Zef, Nji biografi e skurtë e ‘Hyllit të Dritës’, përfshirë në numrin jubilar me rastin e 100-vjetorit të themelimit, Hylli i dritës, Provinca Françeskane Shqiptare, Shkodër 2013

²⁷ Rrota, Justin, “Shtampa”, *Hylli i dritës*, nr. 2, vjeti I, Shtypshkroja Nikaj, Shkodër, nanduer 1913

Revista

Themeluesit e “Hyllit të Dritës” e kishin shumë të qartë misionin e tyre: Ndriçimin e mendjeve të shqiptarëve, që ende nuk kishin nisur të vetëdijësoheshin për faktin se tanimë i përkisnin një shteti të pavarur. Dhe këtë e shprehnin përmes shkrimit të Faik Konicës (Konitza), “Problemi i madh”: *“Kuur tham qi komi shqyptaar, s’kaa edhe nji shpiirt, nuk due me thanë qi i mungon krejt jeta. Komi i jonë, i kjoqshim falë Zotit, po livron me jetë edhe me forcë. Por jeta e tij asht nji farë gjalsiet e verbte e cila nuk e njeh vedin. Komi shqyptaar asht, por nuk din me thanë “jam”; forca e tij, inkohrente e e pashtruese, s’ka as free, as qillim”*. Por janë tërësisht të bindur se shqiptarët janë të aftë për të pasur shtetin e tyre. Në shkrimin “A janë t’zot shqyptarët me u majtë shtet n’vedi?”, At Gjergj Fishta thotë se *“populli shqyptaar nuk asht nji rracë barbare; por asht nji fis, qi me ndimë t’njimendët t’Europës, për pak kohë mundet me u ndërtue e me u majtë Shtet m’vedi”*²⁸.

Deri në momentin e mbylljes së saj, revista përmbushi misionin për të cilin u krijua, si përcues i vlerave më të mira, si ndriçues dhe tregues qytetarie.

“Fletoret e Përkohshmet, tuj ndiekë ditë e për ditë nierin n’gjallim t’vet e tuj vuu oroë nevojët e tii si kahë t’kryemt e detyreve e si kahë gjallimi i vet mii tokë e n’shoqnië, u baa, t’thuesh, vegla maa e para e

²⁸ Hylli i dritës, Nr. 2, Vjeti I, shtypshkroja Nikaj, Shkodër, nanduer 1913,

t'përhapunit t'gjytniës s'vertetë nder tana fiset: një send qi me shumë arsye mundena me thanë, se perparimi i një popullit n'gjytnië njifet maa s'fortit prejë t'përhapunit e prejë t'vjeftunit t'fletoreve e perkohshmet qi aj kaa”²⁹.

**

Deri në mbylljen për një periudhë gati gjysmë shekulli, gjatë regjimit komunist, “Hylli i Dritës” e zhvilloi jetën e vetë në tri periudha për shkak të mbylljeve dhe rihapjeve, për shkak të censurës apo edhe situatës së pafavorshme për shtypin shqiptar, por kjo nuk e ka penguar t’u qëndrojë koherente disa parimeve, kur bëhej fjalë për “fe e atme”. Por jo vetëm. “Hylli i Dritës” është një nga revistat kulturore më jetëgjata dhe më të rëndësishme në lëmë të edukimit qytetar, pra jo vetëm atij fetar, dhe të gjuhës e letërsisë shqipe.

“Feja, praa, e dashtnija e Atdheut e e Gjindiës e Dia janë njato vegla qi e bajnë njerin t'lum n'ket jetë edhe njetë t'amshueme; pse neper kto nieri kryen detyrët, prejë t'cillave rrjedhë t'gjith lumnia e tij”³⁰.

Periudha e parë përfshin një kohëzgjatje njëvjeçare (1913-14), dhe do të ishte më së shumti një periudhë sprove³¹ për drejtuesit e saj. Megjithëqë kuvendi

²⁹ Fishta, Gjergj, O.F.M., “Themelimi I Perkohshmes”, Hylli I Dritës, Nr.1, Vjeti. I, 1913

³⁰ Hylli i Dritës, nr. 1, vjeti I, Shtypshkroja Nikaj, Shkodër, tetuer 1913

³¹ Kamsi, Eëilli, Shtegtimi i ‘Hyllit të dritës’, përfshirë në numrin jubilar me rastin e 100-vjetorit të themelimit, Hylli i dritës, Provinca Françeskane Shqiptare, Shkodër 2013

françeskan nuk e kishte për të parën herë që botonte gazeta e revista, pas “Albanisë” së Konicës që e bëri jetën e vet jashtë vendit, ndoshta kjo ishte e para revistë me një karakter kaq të gjerë kulturor dhe civilizues. Që në numrat e parë do të trajtohen çështje që lidhen me formimin qytetar dhe atdhetar të shqiptarëve, aftësia e tyre për të bërë shtet, pas 5 vjetësh pushtimi të huaj, çështje të marrëdhënieve mes lirisë dhe fesë, kombësisë dhe fesë, shoqërisë dhe shtetit etj. E bashkë me to edhe shkrime të karakterit historik, kulturor dhe gjuhësor, e sidomos për këtë të fundit, gjuhën shqipe, e cila ende trajtohej si gjuhë dytësore në disa shkolla, pavarësisht se Shqipëria ishte tashmë një vend i pavarur . Rubrika “Bibliografië” jepte udhëzime mbi atë çka duhej lexuar, pasi *“me gjith arrsyje mundena me thanë: m’kallxo se ç’libra kndon, e t’kallxoj se kush jee; pse edhe libri, si shoqi, tujë t’folë e tujë t’kshillue me shkronja t’veta, kadalë e kadalë, t’a mushë menden e t’ban për vedi”*³².

Ofron një material të pasur nga trashëgimia gojore popullore, folklor, pasi *“poezia popullore leen, zhdrivillohet e dahet mas gjenjes s’shpirtit t’popullit, qi kndon, ktu u thomë anmiqve t’Shqypniës, se me pasë ata per t’rmue e per t’shoshitë amtyren e poeziës popullore s’onë, jo veç se nuk kishin me thanë qi shqyptarët jan nji koom i egër e barbar, mu, maa tepër, kishte me ju dashtë*

³² Hylli i Dritës, nr. 1, vjeti I, Shtypshkroja Nikaj, Shkodër, tetuer 1913, fq. 31

me dishmue, se kta janë maa t'zhdivilluem kahë mendja, se nuk janë slavt e Balkanit"³³.

Ndërkaq çdo numër, nën kujdesin e Shtjefën Gjeçovit, ofronte një "kapitull" nga Kanuni i Lekë Dukagjinit në lidhje me çështje nga më të ndryshmet: martesë, pritja e mikut, tokën etj.

Por edhe krijimtari letrare mirëfilli, që nga vjershat e Pjetër Zarishtit, tek Vinçenc Prennushi (Prendushi), At Gjergj Fishta (Castigat Ridendo), Zef Skiroi etj.

Revista merrte pjesë aktivisht në debatet e nxehta të kohës e po ashtu nuk nguronte të shprehte hapur qëndrimin e vet politik, si në rastin e shpalljes së Eielhelm Ëied-it, Mbret të Shqipërisë, për të cilin Vinçenc Prennushi, madje i ka kushtuar edhe një poemsh: "Shpata e Skanderbegut". "Rrokull Shqypniës" apo "Rrokull botës" sillnin lajmet më të fundit, të trajtuara me nota satirike. Kjo periudhë përkonte me një nga më të vështirat për Shqipërinë. Konferenca e Ambasadorëve në Londër, copëtimi i Shqipërisë, ardhja e Princ Vidit.. Ngjarje këto që nuk mund të qëndronin larg penës polemizuese të At Gjergj Fishtës. Kjo ishte një arsye boll e qartë dhe e mjaftueshme (sidomos pas botimit të "*Nji komedi e pandershme e t' XX qindvjetë*"³⁴) që përfaqësitë e fuqive të

³³ "A janë t'zot shqyptarët me u majtë shtet m'vedi?", *Hylli i Dritës*, nr.5, vieta I, Shkodër, fruer 1914

³⁴ "E po, tash, shka bani Eurooa per ket punë? Kurr gjaa! N'Europë nuk lehi një qen pse një grusht slav e grek e kishin perbuzë gjygin e popujve maa t'fortë e maa t'gjytetnuem t'rrokullies s'kasajë bote, e se kishin poshtnue tagrin e t'drejtat e një komit...", "Nji komedi e

mëdha që gjendeshin në Shkodër të urdhëronin mbylljen e revistës³⁵.

Revista do të rihapej në vitin 1921, duke shënuar kështu periudhën e dytë të jetës së vet, deri në mbylljen e saj sërish në vitin 1924. Është një fillim i ri, optimist, por me kërkesa të reja. *“Ani pra na të “Hyllit të Dritës”, tuj ndjekë fill e perpe programin e hershem tonin, ktu duem me skjyrtue pak si kthelltë me mikroskop të së vërtetës e t’atdhedashmiës nder tejza të trupit të Shtetit shqyptar, për me pa e me i diftur komit, se kush janë ata mikrob, qi tuj helmatisë gjakun e komit, vën në rrezik jeten e ekzistencen e Atdheut. Nuk asht mjaft qi të jet ba Shqypnija: duhet t’a majmë!”*³⁶.

Çështje të edukimit, të arsimimit, të moralit të shëndoshë zunë vend gjerësisht në faqet e “Hyllit të Dritës” gjatë kësaj periudhe të dytë. Vazhdon t’i kushtohet rëndësi folklorit, por edhe krijimtarisë letrare të autorëve si Dom Ndre Mjeda, Atë Gjergj Fishta³⁷, Marin Sirdani, Vinçenc Prennushi. Botohen “përshtypje udhtimi”, por edhe ndonjë recensë a kritikë libri nga Lumo Skëndo (“Duke kënduar një libër”). Tek-tuk shihen bulëza përkthimesh nga letërsia e huaj si Manzoni , përkthyer nga Vinçenc Prennushi.

pandershme e t’ XX qindvjetë”, *Hylli i Dritës*, nr. 10, vjeta I, korrik 1914

³⁵ Willli Kamsi, *Hylli i Dritës, 1913-1944. Bibliografi kronologjike*, Botime Françeskane, Shkodër 2008.

³⁶ “Rreziku i permrendshem”, *Hylli Dritës*, nr.1, Vjeti II, maj 1921

³⁷ Nis e botohen episode nga “Lahuta e Malcis”

Në vitin 1924 do të ndodhte Revolucioni i Qershorit, i drejtuar nga Fan S. Noli, Luigj Gurakuqi e Bajram Curri, që do të rrëzonin Ahmet Zogun me synimin e vendosjes së një shteti demokratik, çka rezultoi e dështuar dhe për 6 muaj, Zogu do të rikthehet në pushtet. Në këto kushte, revista detyrohet të pezullojë botimin.

Periudha e tretë (1930-1944), do të ishte edhe ajo më e shndritshmja në historinë e “Hyllit të dritës”, duke e kthyer atë në një nga organet me të rëndësishme në lëmë të kulturës dhe të mendimit shqiptar. Ishte momenti që “Tash qi asht ba Shqypnija, duhen përba shqyptarët”. Por kjo mund të bëhej vetëm me kulturë.

“E po Shqypnija- Atdheu i jonë i dashtun? Mjerisht duhet me thanë, se ene gjendemi në fund të shkallës së kulturës. Duhet me shkue s’ dij sa pash poshtë nën dhe, për me hasë pa hiri më ndonji thermi monumentit të kulturës së katragjyshave, të stërgjyshavet t’ onë, sa s’ gjen kund shej kulture shqiptare mbi dhe. Ndoi kishë e shkatrrueme, disa xhamia; që të gjithë monumentat e Shqypnis. E at herët me shka mund të mbaj uzdajë na se komi shqyptar mund do të ketë rruesë të gjatë e të lumnueshme? Secili popull ka tagër me jetue më vedi, po kje se asht i zoti me mbajtë vedin. Mirë po një popull i pa kulturë në Evropë sod me sod nuk mund t’ a mbajë vedin. Kultura i ban njerzt t’ aftë për të kryem, detyrat ma së miri e për të mbaruem,

në pak kohë e pa shumë mund, punë të mëdha e të randa...³⁸”.

Tash që Shqipëria ishte në mes të një qerthulli idesh e rrymash, mes dëshirës për të ecur drejt Perëndimit, por me një të shkuar të gjatë si pjesë e një perandorije të Lindjes, në kohën kur bota ishte në prag të një lufte të re, kur idetë komuniste kishin përfshirë Europën dhe jo vetëm, Shqipëria, duhej të bahej, Shqipëria duhej të zgjidhte. “Prej kahë do të nisemi e ku do të kapemi!”³⁹, shtronte pyetjen “Hylli i Dritës”.

“Që me ditën e independencës s’onë, jeta shqiptare erdh e u zhvillue aq sa sod me siguri mund të thomi, se jetës primitive i asht prish viza, doket shqiptare gjenden në prakun e nji metamorfoze, e njajo kokme, brenda së cilës u mertis jeta shqiptare tash sa mot e vjet sod e çil, për me marrë nji trajtë të re qytetnimi, e cila do të jetë rilindja shqiptare. Na sod ndollim në kohën e tranzicjonit; prandej nuk ka se si vijon ma në gjejen statike jeta shqiptare, por, dashtë e pa dashtë, mirë a keq, tradicjonet, doket, pikëpamja e jetës komtare e përban karakterin e shqyptarit, tash e mbrapa do të përllahet prej rrymave e frymsimeve kulturave e botore të cillave ma nuk mund u hikin as s’mund u pështojm. Kahë e shohim kjartë e e prekim me dorë kët fakt, me nji herë na tëfaqet pëvetje:

³⁸ “Kultura”, *Hylli i Dritës*, nr. 1, Vjeti VI, Shkodër, kallnduer 1930

³⁹ Po aty

kahë duem me i a mbajtë? Kahë duem me i dhanë jetës shqiptare?”⁴⁰.

Dhe përgjigjen për këtë pyetje e jepte vetë redaksia, duke u ofruar lexuesve një gamë të gjerë shkrimesh me karakter studimor, historik, gjuhësor. “Hylli i dritës”, do të qaste rreth vetes albanologë të shquar si Norbert Jokl, Georg Stadtmüller etj. Qëmtimet folklorike do të ishin të përhershme në faqet e “Hyllit”, aq sa edhe krijimtaria letrare. Vetë Gjergj Fishta do të botonte në faqet e saj, pjesë nga veprat e tij si “Lahuta e Malcis”, “Mrizi i zanave”, “Ifigenia n’Aulli”, “Gomari i Babatasit” (pas vdekjes); At Anton Harapi boton “Valë mbi valë” etj.

Çështje të gjuhës dhe të letërsisë do të ishin parësore në revistë. Shkrimet që trajtonin probleme që lidheshin me gjuhën ishin të përhershme në revistë, madje ndodhte që t’i riktheheshin të njëjtës çështje edhe pas disa numrash apo edhe vitesh.

“Ndër temat kulturore që gjetën trajtim dhe hapësirë të veçantë në revistë ishin çështjet e gjuhës shqipe, si tipari kryesor i kombit shqiptar, mbarëvajtjen e së cilës gjithashtu klerikët françeskanë, që nga autorët e vjetër të shqipes, e kishin shumë për zemër. Bashkëpunëtorët kryesorë të “Hyllit” kishin formim të shëndoshë filologjik, etnologjik e historik”⁴¹.

⁴⁰ “Prej kahë do të nisemi e ku do të kapemi!”, *Hylli i Dritës*, nr. 1, Vjeti VI, kallnduer 1930

⁴¹ Omari, Anila, Kontributi i ‘Hyllit të Dritës’ në studimet filologjike shqiptare, përfshirë në numrin jublar me rastin e 100-vjetorit të

Kështu, do të botoheshin në faqet e saj monografitë studimore “Për gjenezën e literaturës shqipe” të prof. Eqrem Çabejt, “Fjalori toponomastik” i Dom Nikollë Gazullit (pseudonimi ‘Gelasius’), “Gjurmime të nji moji në Romë” e “Dorëshkrime të Bibliotekës Nacionale të Parisit” të prof. Filip Fishtës, “Mesharit” të Buzukut i kushtohen numra të tërë përgjatë vitit 1930, për të vijuar me të tjera kontribute nga Prof. Athanas Gegaj, At Gjon Shllaku, At Rrok Gurashi etj.

“Një kontribut të rëndësishëm ka dhënë Hylli i Dritës në studimet filologjike të teksteve të vjetra shqipe. Françeskanët, si vijuesit e veprës së autorëve të vjetër, ishin më të interesuarit për botimin e njohjeve të teksteve të tyre nga lexuesi bashkëkohas, edhe në funksion të studim të gjuhës së tyre për të nxjerrë përfundime shkencërisht të sakta për gjuhën e përbashkët letrare”⁴².

Por nuk mungonin edhe shkrimet kritike mbi veprat e reja letrare që dilnin asokohe, si në rastin e “Hija e maleve” e Koliqit, shkruar nga Criticus dhe e cilësonte si “të padenjë” mënyrën se si feja përmendej; për “Psallme murgu” të Asdrenit etj.

themelimit të ‘Hyllit të Dritës’, Provinca Françeskane Shqiptare, Shkodër 2013

⁴² Omari, Anila, Kontributi i ‘Hyllit të Dritës’ në studimet filologjike shqiptare, përfshirë në numrin jublar me rastin e 100-vjetorit të themelimit të ‘Hyllit të Dritës’, Provinca Françeskane Shqiptare, Shkodër 2013

Një numër boll i vlefshëm është ai kushtuar At Gjergj Fishtës në 60-vjetorin⁴³ e lindjes me shkrime kritike nga F. Cordignano, poezi të Koliqit, ato çka thotë shtypi i huaj e shqiptar për Fishtën etj.

Nga letërsia e huaj botohen fragmente nga “Iliada”, “Hermani dhe Doroteja”, “Quo Vadis”, “Eneida” etj.

Ndërkaq vijonin shkrimet polemizuese nga Fishta e At Anton Harapi, në çështje të ndriçimit të mendjes së shqiptarëve. Në kushtet e Luftës së Dytë Botërore, qëndrimi i tyre politik ishte i qartë: kundër bolshevizmit. Në fjalimin e tij mbajtur “me rasen e betimit të vet përpara Parlamentit më 13-I-1944”, Patër Anton Harapi, teksa shpjegon arsyet pse pranoi të bëhej anëtar u Këshillit të Naltë të Regjencës, ndër të tjera shprehet:

“Edhe komunistavet due t’ua them një fjalë, por kjoartë e shkurt. Unë jam i bindun se pak janë ata shqiptarë, të cilët vërte e kuptojnë doktrinën komuniste, por, tashma, të gjithë po e shohin edhe po e njohin organizatën dhe veprën komuniste në Shqipëri. Unë due t’u besoj, por ky dallim midis doktrinës komuniste dhe veprës komuniste e formën kombëtare-sikurse i kam ndigjue unë dhe vetë tue dishmue organizatorët komuniste-mua më ban me dyshue për sinqeritetin e kësaj rryme shqiptare. Pse, vall, komunistat veshen e ngjeshen me zellin atdhetar, kurse atyne mbi të gjitha u intereson doktrina dhe jo atdhey? Masat terroriste, mandje, vllavrasja, lidhnija e ngushtë

⁴³ Hylli i Dritës, nr.10, vjeti VII, tetuer 1931

deri në dependencë të plotë prej dorës së huej, dhe përdorimi i çdo mjete për qëllim nuk i lanë vend dyshimit. More, me kobure në gjoks nuk bahet kush as vlla as shoq, por ja skllav, ja mizuer apo hypokrit. Gjithmonë tue rrënue, nuk ndërtohet”⁴⁴.

Pas vdekjes së At Fishtës që ishte themeluesi dhe drejtuesi i revistës, ajo u drejtua nga At Benedikt Dema, megjithatë në rëvistë mbeti e shkruar: “Themelue në vjetin 1913 nga At Gjergj Fishta”.

Me ardhjen në pushtet të regjimit komunist, revista do të mbyllej, e bashkë me të do të vinte edhe persekutimi i klerit katolik shqiptar.

Dëshmi është edhe lumturimi nga Papa Françesku i 38 martirëve të kishës katolike. Numër që në të vërtetë ishte shumë më i madh se 38. Kleri katolik u përndoq e u persekutua. Ishin me dhjetëra ata që provuan burgjet komuniste dhe torturat më çnjerëzore. Shumë u dënuan me vdekje, mes të cilëve At Anton Harapi, At Giovanni Fausti, At Daniel Dajani, françeskani Gjon Shllaku, Dom Lazër Shantoja, Dom Aleksandër Sirdani, At Bernardin Palaj, e shumë e shumë të tjerë. Sipas studiuesit dr. Dom Nikë Ukgjini, sipas një statistike mësohet se gjatë periudhës (1945-1980), që kur regjimi komunist dominonte, kishin vdekur nëpër burgjet e shtetit 2 argjipeshkëv, 5 ipeshkëv, 1 abat, 65 priftërinj dioqezanë, 33 françeskanë, 14 jezuitë, 10 seminaristë dhe 8 murgësja. Gjithsej 136 persona.

⁴⁴ Hylli i Dritës, nr.1, vjeti XX, Shkodër, kallnduer 1944

Ndërsa ata që tashmë kishin vdekur, u dënuan me persekutimin e veprës së tyre, si në rastin e epikut të madh, At Gjergj Fishtës.

“Hylli i dritës” do të rihapej përsëri me nismën e françeskanit At Zef Pllumi, në vitin 1993, për t’u mbyllur në vitin e vështirë 1997. Në vitin 2006 “Hylli i Dritës” shënon hapjen e saj të pestë.

Abstract

Censorship was a common phenomenon during the twentieth century, encountered during the regime of King Zog, but culminating during the communist regime. The target was intellectuals. The magazine "Hylli i Dritës" was one of those organs that was censored both during the Zog regime and during the communist dictatorship. The magazine "Hylli i Dritës" is one of the longest-running religious-cultural magazines, founded in Shkodra in 1913 by Father Gjergj Fishta in a complex political and social context. In its pages we can find the biggest names not only of the Franciscan order, but also famous writers, poets and researchers of that time, from Father Gjergj Fishta, Father Anton Harapi, Father Vinçenc Prennushi, Gjon Shllaku, Dom Lazër Shantoja, Eqrem Çabej, Norbert Jokl etc. As the name suggests, "Hylli i Dritës" turned into an orienting star not only for the Catholic faithful, but for all Albanians. But precisely for this reason, "Hylli i Dritës" was a target of politics, both during the reign of Zog I, during which time it experienced several

suspensions, or during the communist regime, when it suffered the heaviest persecution. It suffered the same fate as its executives. Through machinations, manipulations, orders, false trials, the Catholic clergy was persecuted, accused and convicted as if it were a criminal organization. Dozens of personalities of the Catholic clergy and Albanian letters were sentenced to death or sentenced to long years in prison, where many of them lost their lives due to torture. Through this work is described the history, persecution and survival of one of the most important cultural magazines of the first half of the twentieth century.

Keywords: Hylli i Dritës, magazine, Father Gjergj Fishta, dictatorship, King Zog

Jetëshkrimi

Lindur në Fier, më 17.07.1978. Shkollën fillore dhe atë të mesme e kam kryer në qytetin e Fierit. Studimet e larta pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, dega letërsi, Universiteti i Tiranës (1996-2000). Kam djekur shkollën dokorale për studime letrare, po pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës, dhe aktualisht jam në procesin e mbrojtjes së gradës “doktor” me temën “Shtypi letrar në vitet ’30-’40”. Ndërkaq, prej vitit 2000 punoj si gazetare, duke mbuluar fillimisht rubrikat me karakter social dhe më pas kulturor, pranë gazetave Korrieri, Shekulli e prej më shumë se 12 vjetësh në gazetën Panorama. Te kjo e fundit kam mbuluar po

ashtu rubrikat “Dossier” apo “Speciale”, me dokumente e intervista që dëshmojnë mbi dhunën që ushtronte ndaj individit dhe shoqërisë regjimi komunist. Kam marrë pjesë si anëtare jurie në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare (letërsi, arte pamore, kinematografi) dhe jam vlerësuar me çmime për punën time si gazetare. Prej më shumë se dy vjet punoj pranë Ministrisë së Kulturës si Këshilltar i Ministrisë të Kulturës për Mediat dhe Komunikimin.